

**JETON  
NEZIRAJ**

**PEER  
GYNTI  
NGA  
KOSOVA**





**JETON  
NEZIRAJ**

**PEER  
GYNTI  
NGA  
KOSOVA**



Prishtinë, 2017

Jeton Neziraj  
**Peer Gynti nga Kosova**  
(Variant i përpunuar, 2017)

Redaktor i botimit: **Adil Olluri**

Botues: **Qendra Multimedia, Prishtinë**  
info@qendra.org / www.qendra.org

Dizajni dhe thyerja grafike:  
**project.graphics**

Fotot në fund të librit:  
**Jetmir Idrizi**

© Jeton Neziraj  
© i këtij botimi: **Qendra Multimedia**

Ndalohet botimi, inskenimi dhe shfrytëzimi i  
çfarëdollojshëm i këtyre dramave, në tërësi, apo  
pjesërisht, pa lejen paraprake të autorit e botuesit.  
info@jetonneziraj.com

Shtypi:  
**Printing Press**

## **PEER GYNTI NGA KOSOVA**

**PREMIERA:** 24 maj 2017, Teatri Oda, Prishtinë

**Autor:** Jeton Neziraj.

**Regjia:** Agon Myftari.

**Aktorë:** Tristan Halilaj, Donikë Ahmeti, Shpetim Selmani dhe Ernest Malazogu.

**Skenografia:** Nicola Minssen.

**Kompozitor:** Gabriele Marangoni.

**Kostimet:** Yllka Brada.

**Dramaturg:** Stefan Schletter.

**Dritat:** Denis Berisha.

**Menaxhere e skenës:** Lendita Idrizi.

**Koordinatorë e programit:** Blerta Neziraj.

**Asistentë produksioni:** Sophia Sinani; Drilon Azemi.

**Asistente e skenografisë:** Yllka Brada.

**Realizimi i skenografisë:** Ekrem Xhaka.

## RRËFIM PËR NJË ËNDËRR TË DËSHTUAR

Peer Gynti nga Kosova është rrëfim për një ëndërr të dështuar. Para luftës së ndodhur në Kosovë, Peeri i ri, i udhëhequr nga një shpresa për jetë më të mirë dhe të lumtur, nisët për të kërkuar ta ardhmen në “parajsën” e quajtur Evropë.

Ajo që ndodhë me këtë të ri gjatë udhëtimit emigrues, i shpalos përvojat e shumë *desperadove* të rinj, të cilët çdo vit, të mbushur me shpresë për një jetë ndryshe përtej kufijve, e lëshojnë atdheun e tyre. Në *atdheun* e tyre të ri, ata shpeshherë ndihen të keqtrajtuar nga autoritetet, të izoluar e të papërfshirë në shoqëri dhe me ndjenjë nostalgjie për shtëpinë e të parëve. Kështu që, jo rrallëherë ëndrra për një jetë më të mirë u bëhet një makth i vërtetë.

Në dëshirën e tyre për t’u pranuar në rrethin e ri, ata shpesh bien viktima të shokëve të këqij, të cilët ua ofrojnë “sigurinë e munguar”. Peer, personazhi kryesor i kësaj drame, e gjen veten të respektuar në një grup shqiptarësh, të cilët ia tregojnë atij shkathtësitë kriminale dhe i garantojnë siguri. Megjithatë, ai shpejt bie në burg. Gjatë kësaj periudhe burgu, te ai gradualisht fillon procesi i radikalizimit. Religjioni i jep atij “kurajë”, “kuptim jetësor” dhe ia “forcon vetëbesimin”. Këtu drama merret me një problem aktual në shoqërinë tona—radikalizimin religjioz të të rinjve në burgje. Shumë nga këta të ashtuquajtur “luftëtarë të shenjtë” nga Evropa, që luftojnë në Siri, janë radikalizuar pikërisht në burgje.

Por, pavarësisht seriozitetit të temës, shfaqja asnjëherë nuk bëhet patetike apo didaktike. Në fund, publiku e lë shfaqjen jo vetëm i merakosur dhe kuptimplotë, por edhe i argëtuar në mënyrë të përsosur.

## Shënime të autorit:

*Kjo dramë mund të luhet vetëm me katër aktorë. Në atë rast, njëri aktor e luan vetëm Peer-in, ndërsa tre të tjerët i luajnë të gjithë personazhet e tjera.*

*Ngjarjet në këtë tekst dramatik ndodhin mes viteve 1990 dhe 2017. Është dramë e bazuar pjesërisht mbi një histori të vërtetë, dhe është marrë nga libri "Atdheu në valixhe", që përmban tregime të emigrantëve shqiptarë në Gjermani. Ngjashmëritë eventuale me "Peer Gynt-in" e Ibsenit janë tejet të qëllimshme.*

*Disa nga personazhet e kësaj drame, si për shembull "Zyrtari", paraqiten në disa skena të ndryshme dhe në kontekste të ndryshme dhe në fakt do të duhej të ishin si personazhe në vete (ta zëmë "Zyrtari Suedez", "Zyrtari Gjerman", "Zyrtari i burgut"). Megjithatë, për shkak të ngjashmërive të pabesueshme që kanë mes vete, ata thjesht janë emëruar me një emër të përbashkët, në rastin tonë, si "Zyrtari". I njëjti princip është përdorur, ta zëmë, edhe për dy plakat, atë gjermane dhe atë suedeze, që i shohim në dramë (Oh, për atë Zot, po çfarë dallimesh mund të kenë këto dy plaka evropiane, përpos që njëra jeton në Gjermani, ndërsa tjetra në Suedi! Fare lehtë do të mund të ishin motra binjake).*

*Janë gjithashtu edhe disa struktura tekstore të kësaj drame, që mund të luhen nga secili aktor i ekipit të shfaqjes.*

## **PERSONAZHET:**

PEER

NËNA

BABAI

BELA

BACI

POLICI

ZYRTARI

AVOKATI

PLAKA

PEER JUNIOR



# PËRMBAJTJA

11	ËNDËRRA EVROPIANE
12	NËNSHKRIMI
15	NË QENDRËN E REGJISTRIMIT TË REFUGJATËVE
19	PEER NË TELEFON ME NËNËN
21	TË MBIJETOJMË
25	AZILI I REFUZUAR 1
26	NË AUTOMOBIL
30	VRAPI PËR TE PREHRI I NËNËS
32	KTHIMI I PARË I PEER-IT NË SHTËPI
35	NËNA NË GAZIN LOTSJELLËS
37	AZILI I REFUZUAR 2
38	KALIMI I KUFIRIT
40	DIÇKA SI “GURLLL, GURLLL, GURLLL”
41	NË SHTËPINË E ZONJËS PLAKË
45	INTERVENIM I PAPANASHIKUSHËM
48	AZILI I REFUZUAR 3
49	TË HUMBUR NË TYM MARIHUANE
52	ZONJA PLAKË IDENTIFIKON PEER
53	AKTAKUZA
55	PEER TAKOHET ME TË BIRIN E SAPOLINDUR
57	PEER-IT I ZGJATET BURGIMI
58	NDARJA ME GRUAN
62	VRAPI PËR TE PREHRI I NËNËS (II)
63	MESAZH NGA POLICIA FEDERALE GJERMANE
65	VDEKJA E BABAIT
69	BESA
70	PEER RREGULLON SHTËPINË
73	NËN BOMBAT QË BIEN, PEER TAKON NËNËN
77	KËTU NUK PËRFUNDON KJO DRAMË
79	TAKIMI ME PEER JUNIOR



## ËNDËRRA EVROPIANE

Atje është botë tjetër. Qyteteve s'u shihet fundi. Ndërtesat e tyre janë me qindra kate. Njerëzit ngasin makina të bukura dhe kanë shtëpi të mrekullueshme. Atje është si në parajsë. Secili shikon punën e tij dhe askush nuk ka problem me askënd. Të gjithë punojnë dhe bëjnë jetë të mirë. Jetojnë mirë edhe ata që nuk punojnë. Fushat janë të mbushura me pemë e perime, që këtu s'i kemi parë dhe as s'i kemi dëgjuar. Kur mbetesh pa para, shkon në bankë dhe ju kërkon, e ata të japin, pa qenë i detyruar t'jua kthesh prapë. Vajzat janë të dashura dhe ato nuk të refuzojnë kurrë. Atje është parajsa mbi tokë. Ka dete të pafund dhe lumenj të kaltër në çdo qytet. Shitoret e tyre i quajnë "supermarketet", sepse kanë super ushqime. Mjalti atje është më i ëmbël se ky i yni, kurse bora në male është e shijshme si një akullore. Qenët e tyre nuk të kafshojnë kurrë, kurse mushkonjat nuk të pickojnë, por vetëm të lëpijnë. Dyert e shtëpive i lënë të hapura ditë e natë, askush nuk vjedhë gjë, sepse gjithkush ka gjithçka. Atje, jo vetëm pulat, por edhe gjelat bëjnë vezë. Atje është lumturia. Atje gjithçka është shtruar e praruar me ar. Atje është si në një ëndërr e mirë që do të doje të zgjaste përgjithmonë...

## NËNSHKRIMI

*[Rrugë e mbushur me kanaçe të tymit lotsjellës, fishekë të zbrazur, qepë dhe gjësende të tjera. Shtëllungat e tymit lotsjellës kanë filluar të zhduken ngadalë. Nëna hyn, e udhëhequr nga Peer.]*

NËNA: Përse nuk më tregove që ishte kaq larg?!

PEER: O, s'është larg, nënë. Ja, arritëm. Kujdes tash!  
Janë shkallët.

NËNA: Phu, ç'erë e qelbur e tymit lotsjellës. Nëse babai yt vazhdon të dal në demonstrata, do të vdes shpejtë shkak i mushkërive. I kam thënë, por ai nuk më dëgjon. Sot doli prapë. I mbushi xhepat me qepë dhe doli. Ky tym të vret! Qepët s'të ndihmojnë aspak!

PEER: Përse qepë, nuk e kuptoj? Ja, shoh flegra qepësh gjithkah nëpër rrugë.

NËNA: Qepët t'i nxjerrin lotët, e lotët t'i pastrojnë sytë nga gazi. Por është budallallëk, sepse ky gaz të mbytë, a e nuhatë çfarë ere të rëndë që mbanë? Nuk të bëjnë punë qepët. A arritëm, se po vdes nga kjo erë?

PEER: Arritëm, ja...

NËNA: Arritëm?

PEER: Po, arritëm. Ja, këtu!

NËNA: Sikur nuk më duket si shkollë?!

PEER: Është shkolla, nënë.

NËNA: S'dëgjoj asnjë zhurmë. Qëkur nxënësit qenkan bërë kaq të vëmendshëm?

PEER: S'ka mësim sot, për shkak të demonstratave. Ta thash.

NËNA: *[Pa e dëgjuar Peer-in]* Në kohën time, edhe kur ishim në orë mësimi, zhurma t'i çante veshët.

PEER: Prit këtu jashtë.

*[Peer hyn në zyrën e ofiqarisë.]*

NËNA: Natyrisht, se çfarë tjetër duhet të bëj. Të pres! Tërë jetën kam pritur, dhe këtë gjë di ta bëj më së miri.

*[Peer kthehet me një letër.]*

PEER: Ky është dokumenti.

NËNA: S'je duke më futur në ndonjë telashe?

PEER: Jo, nënë! Ta thash njëqind herë.

NËNA: Nuk ta kam besën. Përse duhej ta nënshkruaja unë, e jo babai? Ai është për këto gjëra.

PEER: E dua nënshkrimin tënd, jo të babait. Babai nuk vjen deri këtu. Ai zor që e di se në cilën klasë jam.

*[Ia jep një laps dhe pastaj ia ofron dokumentin.]*

NËNA: S'kam si nënshkruaj. Nuk shoh ku duhet. Dua ta di çka po nënshkruaj.

PEER: Nënshkruaje tash nënë, mos u lazdro!

*[Nëna nënshkruan.]*

NËNA: Mjaft tash, mbaroi. Më premtu që s'është ndonjë gjë e keqe?

PEER: Tani që e nënshkrove, po ta them të vërtetën!

NËNA: Çka? M trego? Nëse s'është dokument shkolle, do të t'i skuqi bythët me thupër.

PEER: Është një dokument policie. Duan të më arrestojnë dhe me këtë nënshkrim ti u dhe leje ta bëjnë këtë.

*[Nëna, nga beli, nxjerrë thuprën dhe dëshiron t'i bie, por Peer i ikë.]*

NËNA: Kopuk, më thuaj që nuk është e vërtetë!

PEER: Natyrisht që nuk është e vërtetë, nënë. Nuk të kam gënjer, është dokument shkolle.

NËNA: Eh, të njoh unë, gënjen ti, por shpresoj që kësaj radhe nuk më ke gënjer.

*[Peer e kthen dokumentin në Zyrën e Ofiqarisë dhe pastaj nga aty del me pasaportë në duar. Kap nënën për krahu dhe nisen mbrapsht.]*

PEER: Kujdes, kujdes shkallët!

*[Nëna ndalet. Mbetet si e ngrirë. Peer e kap për beli dhe e ngreh mbi supe.]*

NËNA: Lëshomë, ore! Lëshomë, kopuk! Kur u rrite ti të më mbash në krahë?!

*[Largohen me zhurmë.]*

## NË QENDRËN E REGJISTRIMIT TË REFUGJATËVE

*[Stockholm. Në qendrën për regjistrimin e refugjatëve.  
Peer merret në pyetje nga Zyrtari, të cilit, siç duket,  
kjo punë i është bërë rutinë.]*

ZYRTARI: A vuani nga ndonjë sëmundje?

PEER: Jo!

ZYRTARI: A dini të përdorni pirunin?

PEER: Urdhëroni!?

ZYRTARI: Ishte një shaka! Përse e zgjodhët pikërisht  
Suedinë?

PEER: Doja të ikja sa më larg që ishte e mundur.

ZYRTARI: A keni ndonjë të afërm këtu?

PEER: Jo.

ZYRTARI: Arsyeja e largimit?

PEER: Kisha frikë që... Kisha frikë që...

ZYRTARI: Ëhë... Pra, arsye politike. Gjendja kaotike  
në vend dhe pasiguria fizike. Policia ua ka bastisur

shtëpinë dhe kanë kërkuar të paraqiteni në stacionin policorë që t'ju zhdëpin në dru, ngaqë dyshojnë se ju keni shpërndarë pamflete kundër shtetit?

PEER: Jo, por...

ZYRTARI: Apo ndoshta ta kanë rrahur babanë në praninë tënde?! Ia kanë lidhur koqet me tel, kurse nënës ia kanë këputur njërën pullë të fustanit?!

PEER: Jo, zotëri!

ZYRTARI: Po bëja shaka. Mirë, më lërë t'ia qëlloj. Pra, thatë jeni larguar për arsye politike?

PEER: Jo, në fakt unë...

ZYRTARI: Pra, arsye ekonomike? Ua kanë pushuar babanë nga puna?

PEER: Ai nuk ka punuar kurrë.

ZYRTARI: Ashtu?! E kuptoj. Pra, babait tënd i pëlqen të pijë. Ai e rrah nënën në praninë tuaj e kjo ju ka traumatizuar. Prandaj, keni ardhur këtu në Suedi që ta shëroni traumën. E saktë?

PEER: Gjithçka atje më dukej zyrtë. Në shkollë, në shtëpi, në qytet, gjithkund. Nëna ime është gjysmë e verbër, kurse babai është njeri i mirë, por rrëmbehet lehtë. Më ka rrahur disa herë, por vetëm atëherë kur kam bërë sherre. Ndërsa, nëna ëndërron dhe thurë çorapë. Ajo e sheh botën bardhë, do me thënë, dhjetë fish më bardhë se sa që është në të vërtetë. Por, kjo s'është arsyeja përse jam larguar.

ZYRTARI: E cila është arsyeja?



PEER: Ne ishim në klasë, në orën e muzikës. Po këndonim një këngë korale. Unë isha i ulur në bankën e fundit, m'u pranë dritares me xham të thyer. Dhe derisa këndonim, nga jashtë dikush gjuajti brenda një si pullë të vockël. Mbas disa sekondash, klasa u mbush nga një aromë e çuditshme, si e ndonjë parfumi. Dhe pastaj, për një moment, jam shtrirë në tokë. Kam filluar të dridhem e të bërtas; o nënë, o nënë... Pastaj u shtrinë edhe shumë nxënës të tjerë afër meje. Trupi më dridhej dhe sytë m'u turbulluan.

ZYRTARI: *[Mosbesues.]* Ashtu?

PEER: Po, dhe kisha ndenjën sikur trupi dëshironte të dilte nga...

ZYRTARI: Nga?

PEER: Të shkërmoqej, të ndahej në copa. Duart të shkëputen nga trupi, gishtat nga dora, këmbët nga kofsha, barku nga shpina, flokët... Dhe dridhesha e kërceja përtpjetë. Kështu edhe të tjerët në klasë. Na kishin helmuar neve dhe qindra e mijëra nxënës të tjerë.

ZYRTARI: Prit, prit. Nuk po e kuptoj, si mund të jenë simptome helmimi ato që përshkrove?

PEER: Po ja, kështu...

*[Peer shtrihet në tokë dhe fillon të dridhet me tërë trupin, me duar e me këmbë, pa cak dhe pa kontroll. Zyrtari ia plasë së qeshurës. Pastaj qeshë edhe Peer. Zyrtari më pas fillon të dridhet, e pastaj dridhet edhe Peer.]*

ZYRTARI: Kush ju "helmoi"?

PEER: Nuk e di... Flitej se... Por...

ZYRTARI: Natyrisht, nuk e dini. E mrekullueshme. Kam dëgjuar gjithfarë shpjegimesh dhe gënjeshtresh që refugjatët sajojnë kur duan të na bindin dhe të dëshmojnë se kanë arsye të fortë pse kanë ikur nga vendet e tyre. Por, një gjë të tillë nuk ma kishte zënë veshi ndonjëherë. Mrekulli. Gënjeshtër e bukur. Paskeni talent djalosh.

PEER: Por është e vërtetë? Madje edhe mjeku francez, doktor Kushneri ka konstatuar se bëhej fjalë për helmime masive.

ZYRTARI: Eh, tani më bindët. Një francez kurrë nuk gënjen. Sidomos kur fle. A keni ndonjë dokument mjekësor? A keni ndonjë raport zyrtar?

PEER: Jo, nuk kam.

ZYRTARI: Natyrisht, nuk keni. Mirë, merreni këtë formular, plotësojeni dhe ejani pas dy javësh! Ne do të marrim një vendim dhe ju njoftojmë shpejtë nëse pranohet kërkesa juaj për azil.

*[Peer del. Zyrtari 'dridhet' sërish, si Peer më herët, dhe pastaj ia plasë së qeshurës.]*

## PEER NË TELEFON ME NËNËN

S'ke pse qanë!

A më dëgjon?

Nënë...

Jam mirë.

Nuk është keq. Është shumë më mirë se atje.

Oh, pashe Zotin, mos qajë më, po ma këputë shpirtin!

Nuk të kam gënjyer.

Mirë, të kam gënjyer.

S'ishte dokument shkolle, natyrisht.

Nëse do t'ju pyesja, ju s'do të më kishit lënë.

Po, më kanë dhënë banesë që ditën e parë kur erdha.

Është banesë e madhe, nënë. Janë të gjitha aty, asgjë nuk mungon.

Ka jorgan, është ngrohtë.

Këtu nuk ndalet rryma kurrë nënë.

Ka mjaft dritë. Janë dritaret e mëdha

Mos qajë, në e di Zotin!

S'ke pse mërzitesh për mua?

Nga dritaret e shoh lumin. Është një lum i madh, i bukur.

Oh, nënë, nuk jam budalla të bie në lum.

E di, e di, natyrisht se do të kem kujdes.

Nuk e di.

Nuk e di se kur do të kthehem.

Kur të bëhet më mirë atje.

Shkolla nuk më ikë askund. E kryej kur të kthehem.

Na japin mjaft para, ushqim falas dhe asgjë nuk na mungon.

Mbylli dritaret, nënë! Mos e lërë tymin e lotsjellësit të futet brenda!

Hapi dritaret natën!

Ashtu!

Po.

Nënë...

Nënë...

*[Sinjali i linjës së këputur telefonike.]*

## TË MBIJETOJMË

*[Në dhomën e tij të vogël në Stokholm, Peer pi supë. Baci hyn dhe ka një puro të ndezur. I afrohet.]*

BACI: Mos më thuaj, e di. Ndiheh keq, ndiheh si mut. Të kanë trajtuar keq, të kanë poshtëruar. A u tallën me ty?

PEER: Po.

BACI: Kështu bëjnë gjithnjë. Me të gjithë ne kanë qenë të njëjtë. Ata duan të na shohin të nënshtuar, tek u lutemi për ndihmë. Sepse kujtojnë që pa ta ne s'kemi si të mbijetojmë. Si e ke menduar këtë vend?

PEER: Nuk e di, ndryshe... Besoja që njerëzit këtu janë më dashamirës. Dikush më pati thënë që suedezët janë "të ftohtë akull" dhe "nuk qeshin kurrë", por i duan të huajt.

BACI: Na urrejnë. Sepse na konsiderojnë barrë. Gjithandej është njëjtë, edhe në Gotenborg, edhe në Stokholm, në... Prandaj duhet ta marrësh fatin në duart tua.

PEER: Por si?

BACI: Bëje atë që bëjmë edhe ne.

PEER: Unë kurrë s'kam bërë gjëra të tilla.

BACI: As unë. Në Kosovë s'do ta kisha vjedhur as një pulë, le më ndonjë gjë tjetër. Mirë, një pulë njëherë e kam vjedhur, ama kaq.

PEER: E ke vjedhur një pulë?

BACI: Mos më kap për fjale. Bashkë me disa shokë, e pata vjedhur një pulë për Vitin e Ri. Kemi qenë të vegjël. E patëm ngrënë gjysmë të pjekur, e pastaj dy ditë patëm dhjerë hollë.

*[Peer gërditet, lë supën që po pinte.]*

Por ajo që po thosha është: a dëshiron të rrish një qurrash, një varfanjak i pshurrtë që të duhet t'i presësh në fund të muajit një grusht të vockël kronash nga këta; që të duhet t'i durosh thikat e këtyre tek ta përdredhin lëkurën; tek të tallin dhe të fyejnë apo dëshiron të rrosh me dinjitet. Të rrosh si njeri në këtë vend, që pos vend normal nuk është. Nuk është. Suedia është një kontejner i madh bërlloku, në të cilin ne të huajt jemi në fundin e tij. Na vënë në fund, nëse pranojmë të rrimë në fund. Unë jo, unë s'kam pranuar. Kurrë s'do ta pranoja një vend të tillë.

PEER: A s'është rrezik ajo që bëni ju?

BACI: Është rrezik, por nuk është rrezik. Jo për neve, jo për gjërat që vjedhim ne. Ne vjedhim mall serioz. Ne nuk jemi hajna gjepash e konservash. Për ne kanë respekt të gjithë. Edhe policia na respekton.

PEER: Me çfarë kushtesh duhet t'i bashkohem grupit?

BACI: S'ka kushte. Thjesht, na bashkohesh dhe kaq. Në të vërtetë, ka vetëm një kusht. Është, si të them, diçka që nënkuptohet.

PEER: Që është?

BACI: Besa.

PEER: Çka hyn besa këtu?

BACI: I bashkohesh grupit me besën se po të kapën, burgun e ha vetëm ti dhe jo të gjithë. Ne mbesim jashtë. Nuk ka emra!

PEER: Kjo nënkuptohet. Përse do t'i spiunoja shokët!

BACI: Ti më kupton mirë. Kështu e kanë kuptuar të gjithë që janë bashkuar. Dy janë kapur. Kanë qenë nga pak muaj burg dhe kaq. Të tjerët kanë vazhduar normalisht. Kjo na mbanë neve. Prandaj, edhe policia na e ka frikën. Ata e kapin, ta zëmë një pakistanez dhe pastaj, mbas pak ditësh, i tërë grupi futet në burg. E kapin një rumun, e ha tërë grupi. Por, kur e kapin një shqiptar, ata e dinë që e kanë kapur vetëm një dhe jo të tjerët. Kjo gjë i bënë nervoz. Prandaj, edhe sillen keq me neve. Kjo neve na bënë më të fortë!

PEER: E çka, nëse, ta zëmë ndonjëri nga grupi, kapet nga policia dhe i jep emrat tanë?

BACI: Askush nuk e bënë atë gjë.

PEER: Nuk guxojnë?

BACI: Jo, s'është punë guximi. Është punë krenarie. Përse dikush, për disa muaj burg të falura, do të pranonte të jetonte përgjithmonë me njollën që mbanë ai që ka tradhtuar shokët? Kush do ta bënte një gjë të tillë? A do ta bëje ti?

PEER: Kurrë! Edhe sikur të më varnin për koqe në shtyllën elektrike, në qendër të Stokholmit!

BACI: E pra. Kështu edhe unë, kështu edhe të tjerët. Jemi popull besnik. Luftarak. Prandaj, do të fitojmë edhe atje poshtë. Herët a vonë!

*[Baci ia lë mbi tavolinë disa të holla.]*

T'i kesh. Më lajmëro kur të kesh nevojë për ndonjë gjë. E ke vërejtur që ndërtesa është plotë të huaj të të gjitha racave. Nëse ke ndonjë telashe me ndonjërin, vetëm u thua në suedisht Jag är Alban!<sup>1</sup>. Dhe pastaj ikin si prej dreqit. Nuk guxojnë të kenë punë me ne se i tredhim.

PEER: Jag är Alban!

*[Baci bënë të dal, por kthehet sërish, futë dorën në supën që po pinte Peer-i dhe nga aty nxjerrë diçka të vogël. Ia tregon Peer-it.]*

BACI: Krimb!

*[Peeri vjell.]*

BACI: Suedezë të mutit.

*[Baci largohet.]*

---

<sup>1</sup> Unë jam shqiptar!



## AZILI I REFUZUAR 1

I nderuri zotëri Peer,

Autoritetet suedeze e kanë shqyrtuar kërkesën Tuaj për azil politik. Pasi që, kanë analizuar të gjitha rrethanat, kanë marrë këtë vendim:

- Kërkesa juaj për azil në Suedi refuzohet.

Provat që keni ofruar Ju nuk kanë qenë të mjaftueshme për t'i bindur autoritet në favor të një vendimi tjetër nga ky që kanë marrë. Ju nuk keni ofruar dëshmi se siguria juaj personale është e kërcënuar në vendin tuaj. Në intervistën tuaj ka pasur mjaft paqartësi dhe në disa raste dëshmia ka qenë qesharake.

Autoritetet suedeze kanë një sugjerim tejet miqësor për ju: Ju lutem, kthehuni në Atdheun tuaj dhe shkoni të studioni në ndonjë shkollë teatri! Talenti juaj nuk bënë të shkoj dëm.

## NË AUTOMOBIL

*[Peer-i dhe Baci janë në një parking automobilash.]*

BACI: Një automobil duhet të vidhet në pikë të ditës. Pikërisht, atëherë kur askush nuk e pret. Afrohesh, shëtite pak në parking, e zgjedhë njërin që të pëlqen më së shumti. E studion pak, e sheh nëse ka të instaluar alarm apo jo, nëse është në gjendje të rregullt apo mos ka ndonjë defekt... e kështu me radhë.

Me çelësin 'universal' e hap derën, gjakftohtë, ama bash sikur ta hapësh derën e automobilit tënd. Askush nuk do të dyshojë. Kalimtarët mund të bëjnë be e rrufe që ti je pronari. Paj, kujt do t'i shkonte ndër mend që ti mund të jesh një hajdut që e plaçkit një automobil në pikë të ditës. Dhe atë në qendër të qytetit. Askujt, natyrisht! Ja ta zëmë, sot mund ta bëjmë një xhiro me këtë automobil.

*[Peer dhe Baci shtrijnë nga një vijë kokaine në mbulesën e parme të një makine të bukur. E përthithin me hundë dhe pastaj hipin në makinë dhe bëjnë xhiro.]*

PEER: Oh, kjo qenka hata krejt!  
Ku drejtin e gjete këtë shqiponjë, vëlla?  
Po fluturojmë, po fluturojmë!  
Pritna Stokholm, pritna n'krahët e tu!

BACI: Mbahu, mbahu!  
Për mall po shkojmë.  
Thatë nuk kthehemi kurrë.

PEER: Kjo është çmenduri.  
Por më pëlqen.  
Nuk më besohet.  
200 në orë.

BACI: Mbahu, ore, a më dëgjon!  
Dhe kur të mbërrijmë atje,  
mbushi çantat arë!  
Mbushi çantat orë dukati!  
Mbushi çantat diamante!  
Pak cigare, pak uiski na bënë punë.  
Thatë ne s'kthehemi kurrë!

PEER: Kujdes! Është kthesë e madhe këtu  
Kujdes, o njeri!  
Por jo, mbushe gaz, jepi!  
Mos bëj kujdes!  
S'ka vdekje që na zë neve!  
S'ka, s'ka, s'ka...

BACI: Akoma nuk ke frikë?  
Ashtu duhet! Frikë s'duhet të kesh!

PEER: Nuk kam frikë, vëlla.  
Fare s'kam frikë.  
As frikë, as...  
Juhuuuuuu  
Po fluturojmë...

BACI: Kurrë frikë!  
Kurrë...  
Frikë, frikë...  
Ne s'dimë çka është frika  
Vi är Albaner!<sup>2</sup>

---

<sup>2</sup> Ne jemi shqiptarë.

Të gjithë na e kanë frikën  
Të bardhë, të zinj,  
Të verdhë e të kaltër.

PEER: Joooo, kurrë, kurrë...  
Ne nuk kemi frikë,  
Se, Vi är Albaner!

BACI: Se jemi shqiptarë

PEER: Kujdes! Paska mjegull këtej.  
Ej, kujdes!

BACI: Kurrë frikë...  
Kurrë, kurrë...

PEER: Thash mjegull, ta haj dreqi.  
Ndalo, o burrë!  
Frenoooo...!  
O, e patëm...

*[Një krismë e topitur e ndeshjes së dy automobilave.  
Hapësira mbulohet nga mjegulla. Qetësi. Pas pak, Peer  
dhe Baci dalin nga makina me të cilën sapo kanë bërë  
ndeshje.]*

BACI: Ta hajë dreqi.

PEER: Prit, ne goditëm një makinë tjetër? Ku është?

BACI: Eja të ikim, lëre!

PEER: S'mund t'i lëmë.... Por, ku është makina e tyre?

BACI: Ka rënë poshtë, në greminë. Lëre, ikim. Po na  
zunë, do të kalbemi në burg.

PEER: Thua se kanë vdekur?

BACI: S'ka rëndësi... Ikim, ikim më shpejtë...  
Fluturojmë... në Kosovë!

PEER: Në Kosovë?

BACI: Suedia, vdiq për ne... Vi är Albaner! Suedi e  
mallkuar, shkofsh në djall!

*[Largohen me shpejtësi nga aty.]*

## VRAPI PËR NË PREHËRIN E NËNËS

Vrapo!  
Vrapo!  
Edhe më shpejtë!  
Lëvizi këmbët!  
O ngutu, ngutu më shpejtë!  
I ke mbrapa, m'u afër teje.  
Ec përskaj lumit!  
Mbahu për atë pemë!  
Vrapo edhe më shpejtë!  
O, a më dëgjon, vrapo!  
Kalo përskaj ndërtesave të mëdha!  
Nuk ke pse ndalesh aty tek pingu i bërllokut.  
Lëri fëmijët që shesin cigare në rrugë.  
Mos fol me ta, le ta bëjnë punën e tyre.  
Vrapo edhe më shpejtë!  
Ashtu, të lumtë!  
Tash kërce!  
Sërish.  
Edhe një kërcim më të madh.  
Ti mundesh, e dija që mundesh  
Edhe një hopa...  
Ashtu pra, ashtu birë  
Tani, fluturo... Fluturo lirë!  
Tani je i lirë.  
Kujdes kokën, gomar i vockël!

A s'e sheh atë shumëkatëshe?  
Kujdes, o ta futa thupër bythëve!  
Ashtu pra, fluturo bukur!  
Dhe eja në prehrin tim!  
Zbrit dhe eja te nëna!  
Hajde ule kokën n'prehrin tim!  
Njomë'ma gjoksin me lot!  
Dhe pastaj nisja e rrëfe se çka të kanë bërë.  
M'i rrëfe krejt vuajtjet e dhimbjet.  
Duhet t'kesh hequr shumë, biri im  
Qajë, qajë njëherë, ngiju!...

## KTHIMI I PARË I PEER NË SHTËPI

*[Peer ha drekë. Nëna rri pranë tij. E vështron dhe lumturohet me të.]*

PEER: Përse nuk ha ti?

NËNA: Nuk më hahet.

PEER: Merr pak nga pjata ime.

NËNA: Nuk jam e uritur.

PEER: Kjo s'që fasulja e mbramë që kemi?

NËNË: Natyrisht që jo. Çka është kjo fjalë?

PEER: Pyeta.

NËNA: Bukës gjithmonë i bëhet qarja. Për sot kemi, e nesër; ditë e re, nafakë e re.

*[Hyn Babai.]*

BABAI: Bastardët prapë na hodhën gaz lotsjellës! Kot e kanë, ua them, kot e kanë. Asgjë nuk do të na ndalë! Më sillni një mindil të lagur, t'i freskoj këta sy, se do të më pëlcasin.



*[Peer ngrihet dhe i sjellë një mindil të lagur.]*

NËNA: Pashe Zotin, ruaju. Ruaji sytë, aman. Tamam edhe ti të bëhesh si unë.

BABAI: S'është gjë, gaz lotsjellës. Më mbaruan qepët, se s'do t'isha dorëzuar akoma. Por s'e kemi ndërmend të ndalemi. Liria nuk ka çmim. Ne jemi në të drejtën tonë, në tokën tonë. Ata duan të na zhbëjnë nga toka jonë. Barbarët!

PEER: A pati shumë njerëz, baba?

BABAI: Çdo ditë e më shumë. Dhe edhe më shumë policë e ushtarë. Përse nuk del edhe ti?

NËNA: Çka janë këto fjalë? As mos e qo ndërmend.

BABAI: Pse jo, nuk është më fëmijë. Ka plot edhe më të rinj se ky që na bashkohen.

PEER: A mund të vij edhe nëse nuk ha qepë? I urrej qepët, s'i ha dot.

BABAI: Natyrisht, bënë edhe pa qepë.

NËNA: Mos ma nxit djalin. Jo dhe jo! Kurrë! Ti bëj çka të duash, por lëre djalin rehat.

BABAI: Imagjino nëse të gjitha nënat i ndalojnë bijtë e tyre të dalin në demonstrata, kush do të demonstronte? Liria nuk do kushte. Të gjithë duhet të kontribuojnë për të.

NËNA: Ata tani po gjuajnë me gaz lotsjellës, por nesër mund të gjuajnë me plumba.

BABAI: Edhe çka?

NËNA: Si çka? Kurrë s'ta lë djalin, as me qepë e as pa qepë!

BABAI: Më mirë të kontribuoj për Atdhe, sesa të ikë prapë rrugëve të Evropës dhe të bëj... Kush e di se çka ka bërë atje.

*[Peer ngrihet nga tavolina dhe del.]*

BABAI: Më jep diçka të ha.

NËNA: Nuk ka asgjë, as edhe një copë bukë. Rruga nuk të jep bukë.

BABAI: Kujtoja se kishim për sot. Mungesa e bukës është mungesa më e vogël që kemi. Ne nuk kemi liri. Neve na trajtojnë si qenë. Dhe prandaj do të derdhet gjaku.

NËNA: Pashë Zotin, më dëgjo njëherë. Mos e ngazëlle djalin. S'ka përse del edhe ai. Dil ti, por mos e merr edhe djalin. Më duhet dikush të më ndihmoj në shtëpi.

BABAI: Mirë, mirë. Lëre tash. Le të vendosë vet. Nëse është burrë, do të dal, por po s'qe, atëherë le të sillet këtu nëpër fustane grash.

*[Peer kthehet me një qepë në dorë. E shikon babanë në sy dhe pastaj nisë ta ha qepën, pa ia hequr sytë, sikur kështu dëshiron ta bindë se tani "është bërë burrë".]*

## NËNA NË GAZIN LOTËSJELLËS

*[Një rrugë e mbushur me gëzhoja plumbash dhe e mbuluar nga një re tymi i gazit lotsjellës. Larg, shumë larg nga këtu, mund të dëgjohen krisma të topitura armësh dhe britmat e masës, diçka e paartikular që nga këtu dëgjohet si “auuuu”, “auuuuuu”. Nëna hynë e kapluar nga djersët, ecë mes tymit dhe gëzhojave.]*

NËNA: Peer... Peer... Ku je kopuk? Shpresoj që nuk je këtu! Thuprën e kam me vete, ta dish.

*[Babai del nga tymi, si i mbirë nga toka, është i plagosur në qafë dhe këmisha i është skuqur nga gjaku. Flet me një zë si të atij që pas pak do të jep shpirt.]*

BABAI: Gjuani... Gjuani, bastardë!

NËNA: Kush dreqin je ti?

BABAI: Qepë, më jepni një qepë...

*[Nëna e njeh.]*

NËNA: Çka dreqin të kanë bërë kështu? O, po si s'ta paskan këputur krejt gabzherrin, që kurrë nuk më dëgjon. Ku është Peer?

BABAI: Qepë, a ke qepë?

NËNA: Nuk kam qepë, vdis! *[Thërret]* Peer, Peeeeeer...

*[Nëna humbet në tym. Babai, me zërin e ngjizur, flet si përçartë.]*

BABAI: O, jua qifsha robtë!

Gjuani kot me topa uji, me gaz lotsjellës, me armë.

Gjuani, gjuani në çdo sekondë.

Veshët po më ushtojnë nga krismat

Ou, gjuani ja qifshim armiqtë e nënës!

S'jua kemi frikën!

Priteni tash kur t'ju gjuajmë ne!

Në lule të ballit.

Tash ju gjuajmë ne, me gurë, me grushte.

Kemi me jua qi robtë, kemi me ju shkretu

Tash ju kallxojmë qysh mbrohet Atdheu.

Praçka, kush ma mori praçkën

Ah, sa mirë gjuan kjo e bekuar.

N'lule t'ballit...

Më sillni një qepë!

A ka kush një qepë?

Mbretërinë për një qepë!

*[Nëna hyn duke thirrur Peer-in, por del prapë. Babai bënë të flas sërish, por s'ia del të nxjerrë zë. Shtrihet përtokë.]*

## AZILI I REFUZUAR 2

Autoritetet e Mbretërisë së Bashkuar, me autorizimin e Shkëlqesisë së saj, Mbretëreshës Elizabetë II, e kanë shqyrtuar kërkesën tuaj për azil në Mbretërinë e Bashkuar dhe kanë marrë këtë vendim:

-Sir Peer, jemi krenar t'ju njoftojmë se kërkesa Juaj është refuzuar.

Ne kemi hartuar një dosje prej 4567 faqesh, në të cilën kemi renditur argumentet pro dhe kundër. Kundër kërkesës tuaj për azil ka pasur 4566 argumente, ndërsa ka qenë vetëm një argument pro.

Vendimi për refuzimin e azilit tuaj e ka tronditur thellë Mbretëreshën Elizabetë. Ajo madje derdhi edhe një pikë loti, si shenjë solidarizimi për krejt vuajtjet e tua. Por, siç u shpreh edhe vetë Shkëlqesia e saj: “një pikë loti nuk mjafton për një kërkesë kaq të madhe”, siç është kjo e juaja për azil në Mbretërinë e Bashkuar.

Shkëlqesia e saj, Mbretëresha Elizabetë II, prandaj, ju urdhëron që ta lëshoni Mbretërinë e Bashkuar sa më parë.

A dëgjoni, ajo ju urdhëron!

Në vendin tuaj nuk do të ketë kurrë luftë. Më së shumti, mund të ketë grindje mes grave që shesin vezë në pazar, ose mund të ketë ndonjë shkrepje armësh për të festuar Vitin e Ri, por kaq, asgjë më shumë.

## KALIMI I KUFIRIT

Ja, shiko, matanë është Sllovakia.  
Shikoj ato fusha, janë sllovake.

Dhe pastaj vjen autobusi  
Ti hip, e hap gazetën,  
s'e shikon në sy askënd,  
As shoferin kur ta pret biletën.

Po pra, Sllovakia është ajo.  
Ajo lopa atje në fushë.  
Ai qen që po lehë, ato tymnaje oxhaqesh të shtëpive,  
Të gjitha janë sllovake.

Ai merr paratë, i numëron,  
Pas pak, ai humbet mes drunjve,  
Ai nuk kthehet prapë,  
Numëron paratë sërish, i duken pak, e ndjejë,  
Ia vështroj avullin që nxjerrë nga goja.

E dëgjoj,  
Tani i dëgjoj mirë,  
Krismat e drunjve,  
Ca zhurma mëngjesi si "rrap, rrap, rrap"  
S'ka gjela që këndojnë, veç ca qenë që lehin.  
Përse nuk ka gjela, pyes?

Në Sllovaki është kështu, më thotë,  
Gjelat flenë, nuk zgjohen kaq herët.  
Ua patën ndaluar komunistët.  
A më kupton?

Po, i them, kuptoj  
Komunistët

A janë tamam, aq sa duhen?  
Paratë...

Pak janë,  
Paratë nuk mjaftojnë kurrë.

I jap prapë  
Ai i numëron, pastaj buzëqesh.  
Ma zgjatë dorën,  
Dhe pastaj humbet mes drunjve,  
Mes mjegullës që është shtrirë ulët.

Unë fluturoj mbi fushat sllovae,  
Depërtoj përmes asaj mjegulle të dendur,  
Mbi atë lopën që kullot barë  
Mbi kokat e policëve kufitarë  
Fluturoj, fluturoj, fluturoj...

## DIÇKA SI “GURLLL, GURLLL, GURLLL”

Ai e kapë telefonin çdoherë.  
Dhe nuk flet.  
Edhe pse nuk ka sesi flet.

Ma jep nënën!  
Ma jep po të them!  
S’dua të flas me ty!  
S’dua!  
O njeri!  
T’i më kujton akoma fëmijë.  
Hë?  
S’të marr vesh fare.

E ka gurmazin e shpuar.

I them “hej, a më dëgjon, ma jep nënën”.  
E ai murmuron diçka; “gurllll gurllll gurllll”.  
Dikur zhurma e ujit kur derdhet nga shishja.

Ma jep nënën po të them!  
A është mirë?  
A është mirë?

Babai më mbanë inat akoma.  
Ndonjëherë them se ma ka falur.  
Se vërtetë më do.  
Ndoshta edhe më do.  
Por, inat më mbanë.  
Ai kujton se kam ikur, ngaqë jam frikësuar.  
Hej, a më dëgjon, o qepaxhi?  
S’dua të di për ty.  
Mbytu!  
Vdis!



## NË SHTËPINË E ZONJËS PLAKË

*[Në shtëpinë e Zonjës Plakë. Ajo hap derën dhe pastaj e fton të hyjë Peer-in e ngarkuar me qese dhe çanta të mbushura me ushqim.]*

ZONJA PLAKË: Ju faleminderit shumë. Sa gjë e këndshme nga ana juaj.

PEER: Asgjë zonjë. Është vërtetë kënaqësi.

ZONJA PLAKË: Ja, lërinin aty në dysheme, i rregulloj unë pastaj.

*[Peer lë qeset në dysheme.]*

ZONJA PLAKË: Ju lutem, ma bëni qefin, pini diçka!

PEER: Mirë! Bënë një gotë qumësht. Ose lëngë luleshtrydhe. Ose, më sillni një birrë, po patët!

ZONJA PLAKË: Natyrisht, natyrisht...

*[Zonja plakë del mbas birrës. Baci hyn tinëz dhe pastaj fshihet në një kthinë aty afër. Zonja Plakë ia sjellë birrën Peer-it.]*

PEER: Po e pi shpejtë se nuk dua t'ju bezdisë.

ZONJA PLAKË: Nuk ka fare problem. Ju u treguat aq i sjellshëm me mua.

PEER: Eh, zonjë, si t'ju them, kjo botë ka filluar të shthuret. Në vendin tim njerëzit akoma e ndihmojnë njëri-tjetrin, akoma ju japin ushqim të varfërve dhe i ndihmojnë pleqtë. E këtu në Gjermani jo. Më dhemb në shpirt kur shoh të moshuar që u duhet të rrinë në këmbë në metro e askush nuk ngrihet nga ulësja që t'jua lëshoj vendin. Kjo është e tmerrshme.

ZONJA PLAKË: Jam në një mendje me ty. Gjërat e kanë marrë teposhtëzën në këtë vend.

PEER: Siç po ju tregoja më parë... Apo ndoshta ajo s'ju intereson gjë?

ZONJA PLAKË: Natyrisht, më intereson shumë.

*[Dhe ndërkohë që Peer flet, Baci, pahetueshëm, mbrapa shpinës së Zonjës Plakë, fillon t'i plaçkit gjërat me vlerë.]*

PEER: Ju thash, vij nga Kosova. Keni dëgjuar për të, apo jo?

ZONJE PLAKË: Po, natyrisht. Por ma kujto pak, ku ndodhet saktësisht? A është diku afër Rosisë?

PEER: Saktësisht ndërmjet Rosisë, Turqisë dhe Sudanit. Është një vend i vogël, por shumë i bukur. Unë jetoja me nënën, babanë dhe dy motrat e mia të vogla. Por gjithçka mori teposhtëzën atë natë kur erdhën ushtarët e komandantit famëkeq, Al Qasar Ibn Abdul John Gonzales. Po darkonim kur hynë ata. Në fillim e vranë babanë, pastaj e dhunuan nënën...

ZONJA PLAKË: Oh, sa e tmerrshme, sa e tmerrshme...

PEER: Pastaj e vranë edhe nënën. Motrat i lidhën për sanën që kishim në oborr dhe pastaj i dogjën...

ZONJA PLAKË: Oh, sa e tmerrshme, sa e tmerrshme...

PEER: Unë i lusja “ju lutem, më vritni edhe mua...” por ata, duke u zgërdhirë, mëthonin “ty po të dënojmë të jetosh”.

ZONJË PLAKË: Oh, sa e tmerrshme, sa e tmerrshme...

*[Zonjë Plakë fshinë lotët me mindil.]*

PEER: Unë jam i dënuar të jetoj, Zonjë. Por aty nuk përfundojnë vuajtjet e mia.

ZONJË PLAKË: Oh, sa e tmerrshme, sa e tmerrshme...

PEER: Vendosa të arratisesha nga atdheu im. Kam kaluar dhjetëra kufij, i uritur, me javë të tëra pa bukë e ujë, nën krisma armësh dhe nën kërcënime të qenve kufitarë...

*[Baci vazhdon të mbledh gjësende me vlerë. Herë mbas here kalon si hije mbas shpinës së Zonjës Plakë.]*

ZONJA PLAKË: Më duket se dëgjova një zhurmë?

PEER: Pastaj, Zonjë, na futën 18 veta në një furgon pa dritare. Bëmë dymbëdhjetë orë rrugë. A mund ta imagjinosh, 28 veta në një furgon?!

ZONJË PLAKË: Oh, sa e tmerrshme, sa e tmerrshme...

PEER: Po pra, 18... 28 veta zonjë, përfshi edhe gra e fëmijë. Një foshnjë vdiq, nuk i bëri ballë atij tmerri. Por, nëna vazhdonte ta mbante në gji. Nuk shkëputej prej saj.

ZONJË PLAKË: Oh, mjaft, mjaft... Nuk mundem më. Kjo është e tmerrshme. Si mund të ndodhin këso gjërash akoma?

PEER: Po Zonjë, por ky nuk është fundi i vuajtjeve të mia.

ZONJA PLAKË: Mjaft, mjaft. Më kurseni, ju lutem. Jam shumë plakë për këso historish. Më vjen keq për të gjitha vuajtjet tua. Edhe njëherë faleminderit për ndihmën që më ofruat.

PEER: Nuk ka asgjë. Pata kënaqësinë. Dhe siç po ju thosha, ai furgon pastaj u rrokullis në një greminë të thellë.

*[Zonja Plakë ngrihet.]*

ZONJA PLAKË: Po ju përcjelli deri te dera.

*[Zonja plakë tek tash vëren Bacin. Bëhet gati të bërtas, por Baci shpejt ia mbyll gojën dhe ia vë gojë një ngjites në të. E ulë në karrige dhe ia lidhë duart nga mbrapa.]*

BACI: Plakushe e keqe. Nuk pate durim të dëgjosh deri në fund. T'u sos durimi. *[Imitacion Zonjën Plakë]* Oh, sa e tmerrshme, sa e tmerrshme...

*[Peer dhe Baci ngarkojnë valixhet me gjërat që kanë grumbulluar dhe pastaj dalin. Zonja Plakë ciat dhe mundohet të lirohet.]*

BACI: *[Off]* Oh, sa e tmerrshme, sa e tmerrshme...

## INTERVENIM I PAPANASHIKUSHËM

Kjo është skandaloze. Si mund të shfaqim këso gjërash? Hajde le t'i ndalojmë këto marrëzira, në të kundërtën, do të na akuzojnë për racizëm. Si mund t'i trajtojmë kështu të huajt? Publiku s'ka nevojë për këso skenash që nxisin urrejtje. Një bandit i huaj dhe ja, një plakë viktimë, një plakë e pafajshme. Klishe. Klishe. Mos, ju lutem! Hajde të tregojmë diçka tjetër. Përse të mos e rrëfejme një histori dashurie? Publiku i do gjërat sentimentale. Peer dhe ajo, po ia vejmë një emër... Bela? Pra, Peer e takon Belën, dashurohen... Lindin shumë fëmijë... Jetojnë të lumtur... Ia bëjmë disi, e thurim një histori.

Po, Peer, çka je hutuar? Gjej një karafil dhe jepja... Vajzave ju pëlqejnë befasitë.

PEER: Një karafil?! Ku dreqin mund ta gjej një të tillë?

BACI: Mos u bëj budalla. Vidhe një! Ja, në atë kopsht.

*[Peer këputë një karafil. Duket që është nervoz.]*

BACI: Prit, ta ha dreqi!

*[Shkon dhe nga petalet e karafilit, që Peer mbanë në dorë. Heq diçka të vogël.]*

Çka lypë ky krimb këtu tash? Phu, ta haj dreqi, këta krimba të mallkuar, s'lënë pa u shfaqur edhe në një skenë dashurie.

*[Hyn Bela.]*

PEER: *[Ia ofron karafilin.]* Ky karafil është për ju, vajzë.

BELA: Ju faleminderit, por nuk marr dhurata nga të panjohurit.

PEER: Unë nuk jam i panjohur. Unë jam Peer.

BELA: Qenke i huaj në Gjermani? Oh, të huajt vetëm telashe sjellin.

PEER: Po ju, gjermane jeni?

BELA: Jam pak italiane, pak gjermane, pak spanjolle dhe pak gjithçka tjetër.

PEER: Çfarë dreqin duhet të them tash unë? Nuk po më vinë fjalët. Dhe po më dridhen gjunjët, goja m'u kyç si me dry. O Zot, shpresoj që jam në ëndërr.

BACI: Ec, qurran, lëri llafet, lëri ankesat, afrohu dhe puthe!

PEER: Por karafili që vodha? Çfarë duhet të bëj me të?

BACI: Gjuaje! A nuk e kupton që nuk të hyri në punë. Më mirë t'ia kishe ofruar një joint a një qepë sesa atë karafil koti.

BELA: Arrivederci...

BACI: Puthe, hajvan!

*[Peer hedh karafilin, e kapë për dore Bela-n, e tërheq nga vetja dhe pastaj e puthë. Fillojnë pikat e para të shiut.]*

BACI: Ja, edhe pikat e para të shiut... U bë tamam skenë dashurie.

BELA: Oh, kurr s'kam puthur një të huaj. Nuk qenka edhe aq keq.

PEER: As unë kurrë s'kam puthur përnjëherësh një italiane, një gjermane dhe një spanjolle. Nuk qenka edhe aq keq.

BACI: A nuk ju thash që publiku i do skenat e dashurisë. Shihe publikun, po shkrihen nga qejfi. Hej, ti djalë në rreshtin e katërt, o dreq, hiqe atë dorë prej vajzës! Mos e prek!

## AZILI I REFUZUAR 3

Zyra për Emigracion e Landit të Baden-Württemberg, zemërthyer dhe e prekur thellë në shpirt, merr këtë vendim:

Qytetarit të nderuar, të shumëvujturit Peer, i refuzohet - oh, mezi po e nxjerrim nga goja këtë fjalë - por po, i refuzohet kërkesa për azil, edhe politik e edhe ekonomik, në Gjermani.

Anëtarët e komisionit, atë ditë kur morën vendimin, së pari qanë, qanë me lot për të gjitha vuajtjet e këtij djaloshi, por pastaj, qenë të shtrënguar ta refuzojnë kërkesën e tij.

Por, i nderuari Peer, komisioni ju inkurajon që të mos e humbisni shpresën. Ju lutem, kërkoni azil në ndonjë vend tjetër, ta zëmë në Francë. Francezët janë dashamirës. Ata ju kanë bërë shumë të zeza kolonive të tyre në Afrikë, e tani po përpiqen të tregohen humanë. Francezët do t'ju duan. Paq fat, o njeri i shumëvujtur, paq fat o i miri Peer!



## TË HUMBUR NË TYM MARIHUANE

*[Peer dhe Baci pinë marihuanë. Janë bërë tapë. Dhoma është mbuluar nga tymi.]*

PEER: Po e hap pak dritaren, le të dal pak ky tym.

BACI: E kanë thënë filozofët: “ky është tym i ëmbël, s’të bënë gjë”.

PEER: Pas pak do të takohem me Belën, s’kam sesi i dal kështu me këta sy drakulle.

BACI: Derdh pak lot, se lotët t’i pastrojnë sytë. T’i bëjnë më njerëzor.

PEER: Nuk e mbaj mend të kem nxjerr lot ndonjëherë.

BACI: Bëje tani, provoje!

PEER: E kotë, s’më dalin. Pos...

*[Peer, ngrihet dhe nga kuzhina sjellë disa qepë.]*

PEER: Po e hamë nga një qepë.

BACI: Qepë? M’i hiq sysh. Gojës t’i vjen era mut kur ha qepë.

PEER: E para është e vështirë, por pastaj të duket sikur ta hash një mollë.

BACI: Haje ti i pari.

*[Peer nis ta haj një rënë prej qepëve.]*

PEER: Gjithmonë kemi pasur qepë në shtëpi. Babai i hante kur dilte në demonstrata.

BACI: E kam dëgjuar. I hanë qepët kundër gazit lotsjellës. Armiku gjuaj me plumba e me gaz lotsjellës, këta tanët ha qepë. Propozoj që qepën ta vëmë në flamurin tonë.

PEER: Epo, haje një qepë pra, nderoje atdheun.

*[Baci edhe ai nisë të haj një qepë.]*

BACI: O hani qepë, se armiqtë po vinë me tanke.

PEER: Po i ha dy qepë përnjëherësh, le të shkatërrohet ai tank atje.

BACI: Po e ha këtë fletëz qepe, që t'i dridhet sall një qime e pidhit nënës së armikut.

PEER: Po na sosen qepët. Do të vdesim.

*[Vazhdojnë të hanë qepë.]*

BACI: Na qon qepë Amerika, ai vend qepëdashës.

PEER: NATO tash e tutje do ta ndërroj emrin në Aleanca Qepo-Atlantike.

*[Dhoma e tymosur shkarravitet nga qepët. Të dy shtrihen si të pandjenja. Mes tymit, hyn "Nëna". Peer çon kokën dhe mundohet ta shoh.]*

NËNA: Si je bërë kështu?

PEER: Nënë...

NËNA: E kam me vete, ta dish, kam me t'i skuqi bythët, a kupton.

*[Nëna nxjerrë një thupër të hollë dhe ia tregon.]*

PEER: Mos më lër këtu, nënë. Më merr me vete, më ço në shtëpi.

NËNA: T'i s'ke bërë ndonjë sherr këtu?!

PEER: Jo, nënë, asnjë. Kam hëngër një qepë, nënë, si babai. I kam hëngër dy qepë. Tri qepë. Katër qepë, nënë. Si babai...

*[Peer nisët të ecë zvarrë drejt saj, por ndërkohë, ajo, gati pahetueshëm, lëvizë mbrapa, deri sa zhduket në tym.]*

PEER: Nënë... Nënë...

BACI: *[Flet përçartë.]* Një krimb në qepë. E gjeta një krimb në qepë.

*[Dhe derisa hapësira mbulohet nga qetësia, në njërin cep të dhomës paraqitet një tank elektrik në miniaturë që nisët drejt të dyve, që janë të shtrirë. Ngadalë, hapësira e dhomës pushtohet nga zhurma e vogël, por insistuese e 'tankut'.]*

## ZONJA PLAKË E IDENTIFIKON PEER-IN

Ky është, ky është ai djall. E njoh mirë. Vriteni, vriteni, ose mbajeni në burg përjetë! Mos e lini të lirë! Është i rrezikshëm, i pashpirt. Është i huaj. Bëjeni të vuaj, ashtu siç më bëri të vuaj mua. Oh, sa shumë kam vuajtur. Mos e lini të lirë, në dini perëndinë! Ai do t'i grabisë edhe të tjerë njerëz të ndershëm. Do t'i dhunojë nënat e motrat e juaja. Ai duhet të mbahet në burg, të vritet ose të kthehet në vendin e tij. Le ta the qafën nga ka ardhur. Gjuajeni në gropën e luanëve, mbyteni! Është i rrezikshëm. S'na duhen këtu këta mosmirënjohës. Gjermania i ushqen, i strehon, e këta na plaçkitin, na dhunojnë. Ju lutem, a po më dëgjoni? A dëshironi t'jua tregoj njollat e dhunës që ky m'i ka shkaktuar? Janë dy njolla të mëdha. Akoma janë këtu, të nxira. Ja, shikojini!

O, a më dëgjoni, vriteni, mbajeni në burg, o kthejeni në vendin e tij të ndyrë këtë mysliman vrasës! Ndoshta s'është mysliman, por çfarë rëndësie ka, është kriminel i rrezikshëm. Le ta the qafën në Turqi a në Indi, a prej nga dreqin vjen ky... Qen... Vriteni, vriteni!

## AKTAKUZA

Zotëri Peer, apo sido që ta keni emrin e vërtetë, aktakuza ju ngarkon për:

- Vjedhje të rëndë dhe dhunim fizik e psikik të plakës M.V, shtetase gjermane.

Në tërësi, ju akuzoheni edhe për 127 vepra penale, ndër të cilat edhe dyshime të bazuara për trafikim ndërkombëtar të substancave narkotike, shitje ilegale dhe konsumim të tyre.

Ju akuzoheni se keni vjedhur:

- 1847 pallto firmash të ndryshme;
- 45 palë këpucë;
- 2356 farmerka firmash dhe madhësish të ndryshme;
- 88 qafore të reja dhe të përdorura;
- 3 të kuq buzësh;
- 2 vibratorë të përdorur;
- 20 video kamera;
- një fotoalbum privat;
- dy kofsha pule të pjekura;
- 23 mijë marka gjermane;
- 3 pulla sakosh;
- 456 litra alkool;
- 3456 pakosh cigare;
- Dy video kasete porno;
- 1 doracak "Xhihadi për fillestarë"

- 2 Bibla;
- 1 doracak për Joga Indiane;
- Një palë brekë grash;
- Një krehër antik;

Keni durim publik i nderur, lista vazhdon.

Nga thyerjet që keni kryer, janë dëmtuar:

- 128 brava dyersh e automobilash;
- Janë dëmtuar edhe dy tavolina;
- 124 librave u janë ndërruar vendet dhe pronarët kanë pasur vështirësi që t'i gjejnë prapë;
- Në total, 89 veta kanë raportuar se ndihen të kërcënuar dhe se vjedhja u ka shkaktuar trauma;
- Një grua shtatzënë beson që ka qenë e detyruara të lindë një ditë më përpara për shkak të stresit që i ka krijuar humbja e vibratorit të saj.
- Një mace e ka humbur apetitin dhe nga një mace e shoqërueshme është shndërruar në një mace asociale. Tani çdo shihet e vetmuar në metro.
- Keni përdorur 12 pasaporta dhe në Gjermani jeni të regjistruar më 13 emra të ndryshëm. Madje, në njërin prej pasaportave, e keni të shënuar vetëm emrin "Peer".

Gjykata ua ka caktuar një avokat, të cilit edhe ia kemi dorëzuar lëndën tuaj. Sipas kërkesës, ju bëjmë me dije se e kemi njoftuar edhe gruan tuaj.

## PEER TAKOHET ME TË BIRIN E SAPOLINDUR

*[Polici e shoqëron Peer deri te paradhoma ku është Bela. Ajo mbanë në dorën foshnjën e sapolindur. Peer duket i emocionuar. Bela ia lëshon në krahë foshnjën.]*

BELA: Merre birin tënd!

PEER: Kaq i vogël?

BELA: Kaq është!

PEER: Oh, por s'qenka as sa një grusht!

BELA: Kaq janë kur lindin Peer, mos u bëj qesharak.

PEER: Kuci-kuci-kuci...

BELA: Ashtu i thuhet një qenushi të vogël!

PEER: E çka duhet të bëjmë me të?

BELA: Duhet ta rrisim Peer. Duhet ta bëjmë burrë.

PEER: Do ta bëjmë burrë. Rritu shpejtë, bir, bëhu burrë, bëhu i fuqishëm, si babai. Shqelmoi të gjithë ata që të dalin përpara.

BELA: Mos e frikëso, Peer! Dhe mos e mëso aso gjërash!

PEER: Merre, nuk di si ta mbaj.

BELA: Duaje, Peer, duaje. Ja, mund ta puthësh në faqe ose mund t'i buzëqeshësh.

PEER: Ta puthi në faqe? E çfarë faqe se? Merre, mbaje! Kam frikë se po më bie.

BELA: Do të mësohesh me të. Tash kur do ta kesh përfunduar burgun, do të kthehesh në shtëpi dhe do të rrish me të. Do ta shohësh tek rritet, Peer. Apo jo?

PEER: Po, ashtu.

BELA: Kemi thënë, të shkuara të harruara. Kaq ishte. A nuk është e mrekullueshme?

PEER: E shkuar, e harruar.

*[Një zile nga jashtë paralajmëron përfundimin e vizitës.]*



## PEER I ZGJATET BURGU

Komisioni diciplinator i Jugendarrestanstalt Göppingen ka marrë vendim që të burgosurit Peer t'ia falë 3 ditë nga dënimi i tij i përgjithshëm prej 4 vitesh. Komisioni këtë vendim e ka marrë bazuar në sjelljet korrekte dhe progresin evident, që i burgosuri ka treguar gjatë këtyre 18 muajve të qëndrimit në burg. Por pavarësisht këtyre përmirësimeve, komisioni gjithashtu ka analizuar edhe disa vërejtje që gardianët dhe të burgosurit tjerë kanë deponuar për të burgosurin Peer. Pasi janë analizuar të gjitha këto vërejtje veç e veç, është marrë vendimi që:

- Për refuzim të ngrënies së mishit të derrit, të datës 14 janar të këtij viti, të burgosurit Peer i zgjatet masa e burgosjes për 14 ditë e 3 orë'
- Për këqyrje shtrembër të gardianit, zotit Shmitd, Peer dënohet me 4 muaj shtesë burg;
- Kur falej, ai nuk kthehej nga kibla, por në një drejtim tjetër të panjohur, dhe për këtë arsye atij i shtohen 14 orë qëndrim në qeli;
- Për ëndrrën e keqe të parë me datë 11 maj, Peer dënohet me punë të detyrueshme fizike, respektivisht dënohet të qëroj qepë një ditë të tërë, nga mëngjesi deri në darkë.

Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

## NDARJA ME GRUAN

*[Burg. Bela pret në një dhomëz takimesh me të burgosurit. Një polic sjellë Peer-in, i cili e ka dorën të lidhur me fasha dhe fytyrën e gërvishtur.]*

PEER: Ku është djali?

BELA: Në shtëpi.

PEER: Si kështu? Përse s'e ke marrë?

BELA: Peer, duhet të flasim.

PEER: Ta haj dreqi, përse s'e ke sjellë djalin.

BELA: Peer, duhet t'i japim fund kësaj.

PEER: Djaln, Bela, djaln...

BELA: Peer, ky është fundi. Djaln do ta shohësh ndonjëherë, por mua jo. Harromë! S'mundem më! Mjaft më ke gënjyer.

PEER: Nuk të kam gënjyer. S'ishte faji im.

BELA: Po Peer, ishte faji yt, e mora raportin nga burgu.

PEER: S'ishte faji im thash. Këta nuk e kuptojnë, e nuk e kupton as ti. Ai e shau Profetin Muhamed. Pastaj, ma shau Nënë. Një zezak i qimë të ma shajë nënën. Kjo gjë nuk durohet!

BELA: Dhe kaq mjaftoi që ta përgjakësh? Ë? Ta paska sharë nënën ë? Ti ma ke shkatërruar jetën.

PEER: Djalin, përse nuk e ke sjellë djalin?

BELA: Fund! Finito!

PEER: Mezi më ka rritur, dhe një bythë zezaku të ma shajë. S'kisha se si e duroj.

BELA: Rri, vazhdo kështu përgjithmonë. Ky është territori yt. Këtu ndjehesh njeri. Në burg.

PEER: Dhe qeshte... E paralajmërova.

BELA: Por unë jo, unë s'mund të jem peng i budallallëqeve tua. As unë e as djali. Ai po rritet pa të parë. Çfarë babai je kështu?

PEER: E luta, mos, nënën mos... Shamë mua, shajë gjithçka tjetër.

BELA: Adio. Të kam dashur, po, e ndoshta do të të dua akoma, por e di që kjo është më mire. Ndarja.

PEER: Por jo, ai donte të ma shante nënën. Paramendoje, zezaku me ta sha nanen, ham zezak ham qafir, ham ta shan nënën, ej!

BELA: Për mua, për djalin, dhe për ty. Më mirë për të gjithë.

PEER: Nënë e zezakut, hë!

BELA: Mjaft, mjaft, ta hajë dreqi! Mjaft! Mjaft. Më dëgjo. Mbaroi. Fund. Mes nesh, mbaroi.

PEER: Ma jep edhe një mundësi?

BELA: Jo, Peer. S'ka më. Kaq ishte.

PEER: Të premtoj! Ta jap besën!

BELA: Jo.

PEER: Besën. A kupton, ta jap besën.

BELA: Nuk më duhet asgjë e jotja më.

PEER: Do t'i jap fund gjithçkaje. Ta jap besën.

BELA: Vonë, tepër vonë.

PEER: Do të ndryshoj. Do ta mbaj burgun dhe do të kthehem te ju, te ti, te djali.

BELA: Jo, jo, jo! Kaq herë i kam dëgjuar këto fjalë. Gjithmonë më ke gënjyer.

PEER: Vetëm edhe një mundësi. Më herët të kam dhënë fjalë e premtime, por kurrë besën. Tani, po, ta jap besën. Vetëm edhe një mundësi.

BELA: Fund! Kaq ishte!

*[Bela del. Polici hyn, dëshiron t'ia lidhë duart Peer.]*

PEER: A mund ta pi vetëm një cigare.

POLICI: Kjo është e pamundur.

PEER: Të lutem!

POLICI: S'lejohej pirja e duhanit brenda.

PEER: Mund ta pi jashtë. Jam shumë keq, sapo më la gruaja.

POLICI: Ju kuptoj, më besoni, ju kuptoj, gratë dinë të jenë të vështira.

PEER: Të lutem, ta jap besën!

POLICI: Më jep çka?

PEER: Ta jap besën që kthehem, më lini ta pi një cigare.

POLICI: Nuk po kuptoj.

PEER: Besa, është... Edhe vdekja dorëzohet para saj. Vetëm një cigare!

*[Polici turbullohet. Ia lidhë me pranga njëren dorë dhe mandej anën tjetër të prangave e lidh për një radiator të ngrohtores afër derës. E hapë pastaj derën.]*

POLICI: Tani, kështu i lidhur për këtë radiator, mund ta pish një cigare dhe tymin e duhanit mund ta nxjerrësh jashtë derës.

*[Peer nxjerrë një cigare. Polici ia ndezë dhe pastaj niset të dal. Hapësira ngadalë pushtohet nga tymin e cigares. Peer i heq prangat nga dora dhe del. Burgu pushtohet nga alarmi i fuqishëm.]*

## VRAPI PËR NË PREHËRIN E NËNËS (2)

Vrapo!

Vrapo!

Lëvizi këmbët!

O, ngutu, ngutu më shpejtë!

I ke mbrapa, mu afër teje.

Ecë përskaj lumit!

Mbahu për atë pemë!

O, a më dëgjon, vrapo!

Kalo përskaj ndërtesave të mëdha!

Nuk ke pse ndalesh aty tek pirgu i bërllokut.

Vrapo, edhe më shpejtë!

Ashtu, të lumtë!

Tash kërcë!

Edhe një kërcim më të madh.

Ashtu pra, ashtu birë.

Tani, fluturo... fluturo lirshëm!

Fluturo bukur!

Dhe eja në prehrin tim.

Njomë'ma gjoksin me lot!

Dhe pastaj nisja rrëfe çka të kanë bërë.

M'i rrëfe krejt vuajtjet e dhimbjet.

Duhet t'kesh hequr shumë, biri im.

## MESAZH NGA POLICIA FEDERALE GJERMANE

Policia Federale Gjermane është vënë në kërkim të një të burgosuri i cili është arratisur nga Jugendarrestanstalt Göppingen. I burgosuri është i moshës 23 vjeçare, ka rreth 15 identitete të rreme, por njihet me pseudonimin “Peer”.

I arratisuri është përshkruar nga autoritete e burgut si një tip i rrezikshëm, agresiv dhe gjakpirës. Luten qytetarët gjermanë të Landit të Bayernvutenbergut që të kenë kujdes nëse ndeshen me të.

Udhëzojmë qytetarët që këto ditë t’i reduktojnë daljet e panevojshme në rrugë, dritaret e shtëpive të mbahen të mbyllura kurse dyert të kyçen me dry. Këto janë masa të përkohshme. Policia Federale është vënë në kërkim të këtij personi me të gjitha kapacitetet e saja. Janë 2300 policë që po patrollojnë në çdo cep të rajonit, 14 helikopterë, 232 qenë, 89 policë hipur në kuaj dhe 186 policë civilë.

Peer do të kapet shpejtë, por deri atëherë, ju lutem t’i përcillni me vendosmëri udhëzimet tona!

Personi i kërkuar nga policia ka flokë ngjyrë kafe, sy të zinj, ka dukje paqësore, por në të vërtetë rrezaton mllef dhe dhunë; ka trup të mbajtur mirë; dhëmbë të

mprehtë, me të cilët ai mund t'i kafshojë edhe njerëzit. Gardianët njëherë kanë raportuar se ai e ka kafshuar shtyllën metalike të burgut; duart i ka të rregullta, por dorën e majtë e ka shumë më të fuqishme se të djathtën; këmbët i ka elastike dhe me to, sipas gardianëve, ai mund të kërcejë edhe nga një ndërtesë 10 kate.

Ju lutem, nëse hasni në një person që ka këso karakteristika fizike, lajmërojeni policinë menjëherë!

E përsërisim, është tip i rrezikshëm. Ruani fëmijët tuaj! Sidomos pleqtë dhe plakat mund të jenë cak i sulmeve të tij.



## VDEKJA E BABAIT

*[Afër dritares së madhe, e mbuluar me qefin të bardhë, është kufoma e babait. Era i lëkund perdet e mëndafshta të dritares së hapur. Nëna rri në skajin tjetër të dhomës dhe thurë çorapë. Hyn Peer.]*

PEER: Nënë...

*[Nëna befasohet nga ky zë. Lëmshi i rrokulliset dhomës dhe ndalet te këmbët e Peer. Ai e merr dhe duke e mbështjellë ia sjellë nënës.]*

PEER: Nënë, jam unë.

NËNA: Peer...

PEER: Kam fluturuar nënë, ashtu siç më ke mësuar, kam fluturuar.

NËNA: Ai vdiq, Peer, vdiq. Shko shihe! Shihe për herë të fundit!

*[Peer afrohet te kufoma. Ngadalë ia heqë qefinin nga fytyra. Fytyra e babait duket e bardhë. Peer e vështron me kureshtje.]*

NËNA: Duhet ta varrosim shpejtë. Ka qëndruar gjatë kështu. Po qelbet e tërë shtëpia. Të prisja ty, se s'doja ta fusnim në dhe pa e parë edhe ti njëherë, për herë të fundit.

*[Peer e shikon kufomën me përqendrim. Ajo i duket sikur lëvizë. Peer trembet. Kufoma e babait lëshon ca zhurma, si gurgullimë uji. Peer mundohet të vijë në vete.]*

NËNA: Tani e tutje, deri sa t'rrosh, çdoherë që do ta kujtosh, do ta kujtosh si një kufomë. Babanë tim nuk e kam parë kur ka dhënë shpirt, por nënën po. Çdoherë që e kujtoj, e kujtoj vetëm të vdekur. Me gojë të hapur, sy të zgurdulluar, lëkurë të bardhë.

PEER: A la ndonjë amanet?

NËNA: S'kishte se si linte amanet. Ndoshta ka dashur, por s'kishte se si me atë fyt të çkyer tejpertej. Para se të jap shpirt, çoi njërin gisht te vrima në fyt, dhe u mundua të më thoshte diçka, por s'nxori fjalë, veç disa gurgullimave, siç bënte zakonisht.

*[Lëmshi i nënës rrokulliset sërish.]*

NËNA: Ma sjell, Peer!

*[Peer vrapon dhe ia sjell]*

PEER: Po dukesh për bukuri, nënë.

NËNA: Nuk e besoj, po ma bënë qefin. Nuk e kam pasur lehtë tërë këto vite. E sheh sesi është bërë shtëpia, pikon gjithandej, muret janë qarë. Do të rrëzohet shpejtë, e ndjejë.

PEER: Qenka shkatërruar mjaft, por nuk rrëzohet, nënë. E ka ndërtuar babai të fortë. Dhe do ta rregulloj unë.

*[Nënës sërish i ikë lëmshi nga dora dhe i rrokulliset.]*

NËNA: Ma sjellë, Peer.

*[Peer vrapo pas lëmshit.]*

PEER: Si ia bën herëve tjera me këtë lëmsh, nënë?

NËNA: Peer, mos u bëj budalla. Nuk më bie kurrë nga dora. Tani po më dridhen duart, prandaj.

PEER: Përse, nënë?

NËNA: Si përse, jam e gëzuar, a s'ke kupton. E gëzuar që u ktheve. Eja, eja Peer, eja veje kryet në prehrin tim!

PEER: Nënë, nuk jam më fëmijë.

NËNA: Ti për mua do të mbetesh gjithnjë fëmijë. Eja, eja, më përqafo dhe pastaj veje kryet në prehrin tim. Dhe pastaj unë qajë, e lotët e mi të bien faqeve. E ti më pyet: nënë, a po qanë? E unë të them, jo birë, po bie shi.

*[Peer niset nga ajo, si një fëmijë i vogël.]*

NËNA: Hajde, birë. Ashtu!

*[Peer, si një fëmijë i magjepsur, niset drejt saj.]*

PEER: Nënë, nënë.

*[Peer shkon te ajo, vë kryet në prehrin e saj. Nëna pastaj tinëz e nxjerr nga fustani i saj thuprën e hollë dhe fillon t'i bie në vithe]*

NËNA: Tash ta tregoj qefin, i pafytyrë. Nuk ke ardhur tërë këto vite.

*[Peer mundohet të mbrohet. Luajnë.]*

PEER: Mos më rrah, nënë! S'kam bërë asgjë.

NËNA: S'ke bërë asgjë? S'ke ardhur të më shohësh, më ke lënë vetëm.

*[Peer shkëputet nga ajo.]*

PEER: Shiko se çka të kam sjellë?

*[Peer nxjerrë një varg rruza për qafë.]*

NËNA: Çka më ke sjellë?

PEER: Janë rruza, nënë.

NËNA: Nuk i dua.

PEER: Jan rruza smeraldi.

NËNË: Rruza smeraldi?!

PEER: Po, nënë. Janë për ty. Vëri në qafë dhe mos i heq kurrë.

NËNË: Eh, kurrë... Një ditë, madje shpejtë, do të vdes edhe unë si babai yt.

PEER: Kurrë, nënë! Ti nuk do të vdesësh kurrë!

*[Peer ia vë rruzat në qafë, pastaj e vë kokën në prehrin e saj.]*

## BESA

U hutova. S'e kisha dëgjuar kurrë atë gjë. Përpara s'kisha një të burgosur, por një magjistar që m'i mjegulloi sytë, m'i turbulloi ndjenjat. Kur kërkoi të pinte një cigare, unë u ndjeva i obliguar, jo për të, por për atë farë "besën". Ta jap "besën e shqiptarit" më tha. Nuk u besoj fjalëve, i thash. Por "besa" më tha, nuk është fjalë, është... Është... Çka është i thash? "Besa" nuk thyhet. "Edhe vdekja dorëzohet para saj", ja kështu më tha. "Shqiptari, gjallë apo i vdekur, e mbanë besën". Vdekur? Si vdekur? Dhe pastaj ma tregoi një përrallë për një të vdekur që është ngritur nga varri dhe e ka mbajtur besën e dhënë sa ishte gjallë.

Ne, këtu në Gjermani, i thash unë, kur duam ta bindim dikë për diçka, themi ta zëmë "betohem në varrin e nënës" apo "betohem në jetën e fëmijëve" ose... Por jo më tha ai, këto betime s'janë asgjë kundrejt besës. Besa është më shumë se sa kaq. Ajo është më shumë se sa vdekje, më shumë se sa jetë. Ajo është jetë e vdekje përnjëherësh.

S'u deshtë t'i besoja. Një polic nuk duhet kurrë të bie në këso grackash. Unë rashë, e pranoj, dhe jam fajtor. Si mund t'i besohet një të burgosuri? Si mund t'i besohet një kriminel, një dileri të rrezikshëm? Si munda t'i besoj asaj farë "besës"? Më dënoni! Jam fajtor.

## PEER RREGULLON SHTËPINË

*[Peer në një shkallë druri rregullon çatinë e shtëpisë.  
Ndërsa, nëna poshtë thurë çorapë.]*

PEER: Është dëmtuar mjaft, por do ta rregulloj.

NËNA: Po më bëhet zemra mal që të shoh duke punuar.

PEER: Më sheh?

NËNA: Aq sa të shoh, turbull. Por, edhe kur s'të shoh, e di që je këtej afër meje. Tani që babai yt vdiq, vetëm ty të kam.

PEER: Nuk je vetëm. Ke Allahun, që kujdeset për ty.

NËNA: Përse flet kështu? Ti nuk do të largohesh kësaj radhe? Ë? S' dua të kujdeset askush për mua, pos teje.

PEER: Natyrisht, natyrisht. E pata fjalën kur unë nuk jam këtu. Kur dal ditën në pazar ose kur shkoj në pyll për dru ose kur dal në demonstrata.

NËNA: Në demonstrata?! S'të lë të dalësh kurrë. Mjaft ka dal babai yt. E la trupin në ato demonstrata. Lë të dalin të tjerët. A më dëgjon? Ai ishte besatuar me shokë që do të luftonte për Atdhe deri në vdekje. Por ti s'je besatuar me kënd. S'ke pse del.

PEER: Jo, natyrisht, s'jam besatuar me kënd.

NËNA: Në pazar mund të dalim bashkë. Në mal s'ke pse shkon. Nuk na duhen dru njëherë. Dimri është larg.

*[Peer sikur kujtohet për diçka.]*

PEER: Çka është ajo shtëllung tymi aq e madhe atje?

NËNA: Çka është, Peer, çfarë tymi, çfarë shtëllunge?

PEER: Një re e madhe, por është aq e madhe. Eja, eja ta shohësh!

NËNË: Nuk e shoh dot, Peer. S'mund të shoh para këmbëve të mia e lëre më në qiell.

PEER: Oh, është aq e madhe, sa që jam i sigurt do ta shohësh edhe ti. Eja, hip këtu!

*[Peer zbret nga shkalla, pastaj e merr nënën dhe e hip ngadalë në shkallë.]*

NËNA: S'hipi dot aq lart! Lëre Peer, mund të jetë tym lufte nga ndonjë vend i largët.

PEER: Jo jo, s'është edhe aq larg. Hajde, tri shkallë vetëm, sa ta shohësh. Ngutu, ngutu shihe!

*[Nëna me frikë hip disa shkallë, pastaj shikon përreth.]*

NËNË: Ku, Peer, ku është ajo shtëllungë tymi?

PEER: Shiko larg te retë.

NËNA: S'shoh asgjë!

PEER: Epo, mbase iku tani.

NËNA: Gënjeshtar. Më gënjeve? Më zbrit nga këtu tani.

*[Peer mer lëmshin dhe kërrabzat dhe ia gjuan.]*

PEER: Prite lëmshin e kërrabzat. Puno diçka sa të rrish atje lart. S'ke pse rri kot.

NËNA: Ti nuk do të më lësh këtu, apo jo. Nuk guxon ta bësh atë gjë. Ku e kam thuprën? Ma gjej thuprën.

PEER: E ke në brez, nxjerre dhe me thupër largoje shtëllungën e resë që po afrohet. Mirupafshim!

NËNA: I pafytyrë, nënës tënde kështu ti, ë? Kopuk! Ndihmë, ndihmë! Po t'ishte gjallë babai yt, s'do të guxojë të ma bëjë kurrë këtë gjë. O derëzi, që ma nxive jetën. Ndihmë! Ku po shkon Peeeerrrr... Kthehu!

PEER: *[Nga larg]* Kam një punë që po më pret, nënë. Pastaj do të kthehem nënë, do ta ndërtoj një shtëpi të re, vetëm për mua dhe për ty dhe për nipin tënd. Allahu akbar, Allahu ambar!

*[Peer largohet.]*

NËNË: Veç mos të shtifsha në dorë edhe një herë, do ta marrësh vesh.

Dale, për nipin the? Çfarë nipi? Një djalë, paske një djalë? O i ëmbli im, i miri im Peer! Një djalë, Peeri im paska një djalë. Ej, a më dëgjoni...

*[Nënës i bie lëmshi nga dora dhe i rrokulliset.]*



## NËN BOMBAT QË BIEN PEER TAKON NËNËN

*[Siri. Peer është në llogore, me kokë të mbështjellë me një pëlhurë, ku është një mbishkrim arabisht dhe me pushkën e drejtuar nga pozicionet e armikut. Afër tij, Baci bënë thirrje për xhihad. Peer djersinë nga vapa e cila përcëllon, fërkon sytë, sikur dëshiron ta mund gjumin.]*

BACI: Falenderojmë Allahun azuvegjel që na e ka mundësu me shkelë në tokën e Shamit, në tokën e xhihadit fise-bil-Ilah, ku nuk ka as murteda e as kufarë. Falenderojmë allahun azu-egjel që na ka mundësu me u bashku me këta luana prej t'gjith botës për me ardhë me e mbrojnë nderin e motrave tona myslimane, nderin e fëmijëve tonë myslimanë, nderin e burrave myslimanë, nderin e plakave myslimane, nderin e çikave myslimane, nderin e nuseve myslimane, nderin e vëllezërve myslimanë, nderin e kushërinjve myslimanë, nderin e dajallarëve myslimanë, nderin axhallarëve myslimanë, nderin e çikave të axhallarëve myslimanë, nderin e gjysheve myslimane, nderin e tezeve myslimane, nderin e njerkaeve myslimane, nderin kunatave myslimane... e kështu me radhë e kështu me radhë.

Vllazni ju këshilloj, uallahin mos rrini as një minutë në shpijat e juve, banu gati e nisnu në xhihad fisebililah. Uallahi vllazni, veç me e dijtë ju se çfarë jete e çfarë

krenarie ka myslimani këtu në këtë tokë, uallahi nuk kishit nejtë as një minut ma shumë atje.

E kam edhe një porosi për kufarët, edhe për murtedat edhe mushriktë: uallahi o kufarë, mos menoni që fitoni.

PEER: Mos e harro edhe atë pjesën “do t’ju hyjmë në ëndrrat tuaja”. Më pëlqen shumë ajo pjesë. Gjithmonë më kanë pëlqyer ëndrrat.

BACI: Uallahi do të vijë ditë të zeza për ju, o vllazni! Uallahi, do t’keni frikë të ecni në rrugë. Do t’keni frikë të punoni nëpër zyrat e juaja. Do të keni frikë, do të tmerroheni e do të trishtoheni edhe në shtëpitë e juaja. Do të keni frikë, do të tmerroheni e do të trishtoheni edhe në ëndrrat e juaja. Ne do t’vijmë në qytetet tuaja, në shtëpitë tuaja, o uallahin nën jorgan do t’ju hyjmë, në xhepat e këmishëve tuaja, në çantat e fëmijëve tuaj, do t’ju hyjmë në banjo kur laheni, do t’ju hyjmë në tualet ku e bëni kakën... Rezil do t’ju bëjmë, o vllazni.

Do t’bëjmë me ju, ashtu siç kemi bërë me ushtrinë e rafidive. Do t’ju mposhtim juve, me lejen e Allahut Subhanata-ala, do t’ju mbysim.

*[Pas pak, dëgjohet fishkëllima e një plumbi tek godet Bacin.]*

PEER: Si thua, a kthehemi në shtëpi tani? Mjaft luftuam!

BACI: Nëse kthehemi tani, a e di se çfarë do të humbasim?

PEER: Çfarë?

BACI: 72 virgjëreshat të cilat na takojnë në botën e përtejme. Virgjëreshat syzeza janë gra të reja shumë të bukura e të bardha, me bebëza të zeza e retina shumë

të bardha, lëkura e të cilave është aq e brishtë dhe e ndritshme, sa që shkakton hutim. Allahu ka thënë se ato janë si perla të fshehta. Ato kanë sy të mëdhenj dhe nuk janë të prekura nga njeriu apo xhindet. Ato janë virgjëresha që janë të etura për burrat e tyre. Ato mbesin gjithmonë në të njëjtën moshë, shumë të bukura moralisht e fizikisht. Ato janë si barbika.

*[Mbas pak dëgjohet një krismë e madhe në afërsi, si zhurma e një minahedhësi. Baci shtrihet për tokë. Hapësirën e mbulon tymi dhe pluhuri. Peer ngrihet, fshinë me dorë ballin e gjakosur. Gjithçka bëhet surreale. Hyn Nëna. Peer mundohet t'i flas, t'ia tërheqë vëmendjen për rrezikun, por s'nxjerr veç ca zëra të paartikulluar.]*

PEER: Nëënnnëëë... nëënnnnnëë...

*[Në këtë vizion surreal, e tëra duket si një lojë fëmijësh.]*

NËNA: Çfarë je duke bërë këtu, Peer? S'lash vend pa të kërkuar.

PEER: Po e mbrojmë tokën e Shamit!

NËNA: Paske ardhur të mbrosh tokën e huaj, e tokën tënde e ke lënë pa punuar. Shtëpia të është djegur, oborri të është mbuluar me thera. Eja me mua, se ta tregoj qefin.

PEER: Shko në shtëpi, nënë, nuk mund të vij!

NËNA: Nuk shkoj askund pa ty.

PEER: Nuk vij, nënë, jo pa 72 virgjëreshat që më takojnë.

NËNA: O Peer, mos u bëj i marrë! Çfarë virgjëreshash?! Lëri ato përralla!

PEER: S'guxoj ta braktisë frontin. M'duhet të ruaj këtu që të mos t'hynë kufarët.

NËNA: Oh, Peer, mos u bëj budalla! Si mund ta ndalësh armikun me këtë pushkë të prishur?

PEER: Nuk është e prishur.

*[Peer e kontrollon pushkën, pastaj e vëren që ajo s'e ka fare këmbëzën për gjuajtje.]*

NËNA: Eja, gjuaje aty në kaçube. Lëre, Peer, eja se nuk është luftë e jona kjo.

PEER: Ti po më nxitë të largohem nga rruga e drejtë, nënë, nga rruga e Allahut.

*[Nëna nxjerrë thuprën e saj.]*

NËNA: Nuk është kjo rruga e drejtë. Dëgjoje nënën, kopuk! Kthehu në shtëpi!

*[Nëna e ndjekë, Peer ikë. Edhe një granatë e radhës e mbulon hapësirën me një re të dendur tymi e pluhuri. Peer, që është plandosur për tokë, pas pak, ngre kryet shikon për rreth.]*

PEER: Një qepë, ma jep një qepë, se sytë, nënë, po më djegin sytë.

Nënë... Nënë...

*[Peer shtrihet sërish për tokë. Qetësinë e thyen zhurma e tankut elektrik në miniaturë, që shfaqet duke ardhur drejt Peer-it. Baci ngre pak kryet dhe me forcën e fundit, nisë të flas sërish, por flet shkurt.]*

## KËTU NUK PËRFUNDON KJO DRAMË

Kjo që sapo patë, mund të duket një fund logjik i kësaj historie, por nuk është. Këtu nuk përfundon kjo dramë. Nuk mund të ketë këso përfundimi kaq të padenjë për Peer-in nga Kosova, kryeheroïn e kësaj drame. Skena që sapo patë, po, është tragjike, por drama jonë nuk ka fund tragjik. Para se të vazhdojmë tutje, le të themi edhe disa të dhëna që mbase mund t'ju interesojnë.

Peer shkatërrohet fizikisht dhe shpirtërisht, megjithatë ia del të kthehet në Kosovë. Por, fatkeqësisht pa ato 72 virgjëreshat. Peer u kthye ta takoj nënën, por s'e pa më.

Çfarë kishte ndodhur me nënën, nuk mund ta tregojmë. Është prekëse, është... Epo mirë, meqë insistoni. Nëna e tij gjatë atyre viteve kishte thurur 4567 palë çorapë, të cilat ia zinin gjysmën e bodrumit dhe tërë kulmin e shtëpisë. Ditën e kobshme, një tel i vockël rryme, preku diçka të gabuar dhe... shtëpia u dogj. Nëna, që edhe në ato çaste po thurte çorapë, ra nga karrigia bashkë me lëmshin dhe kërrabzat. U shtri për tokë, ndërsa kërrabzat i ranë në dysheme. S'arriti të thoshte më tepër, pos klithmës: "Oh, kërrabzat e mia..."

Kaq.

Kur gjysma e Peer u kthye nga Siria në shtëpi... Po e përsërisim: Kur gjysma e Peer u kthye në shtëpi, krejt çka gjeti nga nëna qenë këto [tregon dy kërrabzat e nënës]. Asgjë më shumë. Edhe thuprën e kishte përbirë flaka.

Por, atë ditë ndodhi edhe diçka tjetër, që duhet ta kujtojmë. Diçka e këndshme, do të thosha. Peer, pasi varrosi të ëmën, njëherë qau bri varrit të saj, e pastaj e hapi zemrën, ndoshta për herë të parë në jetën e tij.

\*\*\*

PEER: Nënë, kurrë në jetë nuk të kam gënjer. Të kam gënjer vetëm një herë, atëherë kur pate nënshkruar atë dokumentin, që të pata thënë se ishte i shkollës. Ishte konfirmim për pasaportë. Ngaqë s'i kisha akoma 18 vjet, kërkohej miratimi i njërit prind.

Por kurrë më nuk të kam gënjer.

Po, mu kujtua, të paskam gënjer edhe njëherë tjetër.

Në Suedi nuk kam punuar kurrë në asnjë shitore lulesh, e as në ndonjë azil pleqsh.

Por, kurrë më nuk të kam gënjer.

\*\*\*

Emocionuese, ë? Epo, ja ky është Peer-i. Peer qëndroi pran varrit të nënës 6 ditë e 5 net dhe i tregoi asaj që nuk e kishte gënjer kurrë, pos atyre 1563 herëve. Ama, jo më shumë se aq.

Por, që të mos humbasim në detaje, vazhdojmë...

Shikim të këndshëm. Nuk ka edhe shumë. Dhe nuk do të mërziteni. Është fund i lezetshëm.

Me insistim të regjisorit, për ta treguar kalimin e kohës, u bë një ndryshim i vockël skenik. Ky ndërrim është bërë shkas që autori i kësaj drame dhe regjisori të zihen mes vete. Tani më nuk flasin.

Vazhdojmë me shfaqjen. Jemi diku në Evropë.

## TAKIMI ME PEER JUNIOR

*[2014. Parku i qytetit në Stokholm. Peer dhe Plaka janë ulur në njërën prej ulëseve aty. Përreth dëgjohen cicërima zogjsh dhe zhurma fëmijësh që lozin aty afër.]*

PEER: Lufta zonjë, lufta është... Lufta është luftë. Është e thjeshtë. Është e komplikuar, por është e thjeshtë në anën tjetër. Këtu je ti, në anën tjetër janë ata. Ata duan të të vrasin, të të asgjësojnë, ti mbrohesh dhe po munde, i vret ata.

Por, krejt çka duhet të bësh është të mësohesh me zhurmat. Zhurma bëhet armiku yt kryesor. J anë të tmerrshme zonjë. Fishkullimat e plumbave tek të kalojnë përskaj kokës, pastaj zhurmat e granatave tek bien afër teje, e pastaj zhurmat e minahedhësve. Zhurma, zhurma... I dëgjon edhe në gjumë, edhe kur e ha atë supën e hollë me ujë e kripë, edhe kur, i mbështetur për lisi mundohesh ta bësh shurrën, tërë kohës i dëgjon.

PLAKA: Por, ti tani nuk ke ndonjë problem me veshët? S'ke ndonjë dëmtim të membranës?

PEER: Tani dëgjoj shumëfish më shumë, zonjë. Dëgjoj gjithçka, edhe zhurmat që nuk duhet t'i dëgjoja. Ju dëgjoj juve kur merrni frymë, ecjen e atij buburreci në bari.

PLAKA: Por, po më tregonit edhe për nënën. Jeton ende?

PEER: Histori e dhimbshme, zonjë. Kur u ktheva nga mali, me pushkë në krah, krenar, shtëpinë e gjeta të djegur, ishte bërë shkumb e hi.

PLAKA: Nëna?

PEER: Hi e pluhur. Vetëm kërrabzat ia gjeta. Ja, këto dy kërrabza

*[Peer nxjerrë nga dy kërrabzat e nënës. Plaka hapë çantën e saj, nxjerrë faculetën dhe i fshinë lotët. Peer, tek sheh çantën e saj hapur, ngadalë, futë dorën dhe ia vjedhë portofolin.]*

PEER: Ajo vazhdimisht më këndonte;

*“Ashtu pra, ashtu bir,  
fluturo bukur...  
Dhe eja në prehrin tim!...”*

Akoma më bëhet se e dëgjoj këtë këngë të saj. S’më hiqet nga mendja.

PLAKA: Oh, sa e tmerrshme. Më vjen shumë keq.

PEER: Njeriu mësohet me dhimbjen.

PLAKA: Ku do të rrini këtu në Stokholm?

PEER: Akoma nuk e di. Ditë e re, nafakë e re, themi ne.

PLAKA: Do t’ju ndihmoja me kënaqësi, por s’kam sesi. Madje, sot nuk e kam as portofolin me vete, se do t’ju kisha lënë ca para me kënaqësi.



PEER: As mos e zini në gojë, zonjë. Ia dal mbanë, kam mjaft para. Kjo mjegull edhe mund të sjellë shi, por jam mësuar edhe me shiun.

PLAKA: E marr me mend. Lufta ju ka skalitur. Epo, atëherë, po ju lë. Vërtetë më vjen keq për të gjitha vuajtjet tua.

PEER: Faleminderit që pate durim të më dëgjoje.

*[Plaka ngrihet dhe nis të dalë]*

PLAKA: Kjo qenka një ditë e madhe për Ju. Paç fat! Shpresoj që djali t'ju ketë përngjarë juve.

PEER: Mirupafshim, Zonjë!

*[Plaka del. Peer nxjerrë portofolin që ia vodhi plakës, i heq paratë nga aty, ndërsa portofolin e hedh mbrapa pa kujdes. Hyn Peer Junior dhe Peer emocionohet.]*

PEER: Gabriel.

PEER JUNIOR: Baba.

PEER: S'qenke rritur sa kujtoja. Si kështu?

PEER JUNIOR: Mjaft jam rritur, aq sa duhet.

PEER: Në internet dukesh më i madh.

PEER JUNIOR: Në internet edhe ti dukesh më ndryshe.

PEER: Ashtu ë? Si është ajo... Nëna jote?

PEER JUNIOR: Mirë është. Punon shumë.

PEER: Ashtu, ashtu. Hë, shkojmë të pimë ndonjë gjë të ngrohtë. U mërdhiva në këtë park? Qeras unë.

*[Peer merr pastaj patericat që i ka afër dhe ngrihet. I tërheq zvarrë dy këmbët artificiale. Të dytë nisen ngadalë.]*

PEER: Shkolla?

PEER JUNIOR: Nuk më pëlqen. Është shumë e mërzitshme, baba. Çfarë ere e keqe vjen në klasë. Të gjithë pordhin e dhiesin në brekë. Fëmijë të dreqit, nuk dinë gjë tjetër. Nuk dua të rri aty.

PEER: Mos e ekzagjero, nuk është edhe aq keq në shkollë. Ja, bëni edhe këso shëtitjesh të mrekullueshme nëpër Evropë.

PEER JUNIOR: Dhe çfarë na tregojnë në këto shëtitje? Muze koti, shfaqje të mërzitshme për fëmijë. Nuk më pëlqen Evropa. Dua të shkoj në Amerikë. Amerika, baba, është botë tjetër. Qyteteve s'u shihet fundi, kurse ndërtesat në to kanë me qindra kate. A e ke parë sesi duket Nju Jorku në televizion? Si një ëndërr. Por s'është ëndërr baba, është realitet. Njerëzit atje ngasin makina të mëdha e të bukura, dhjetë fish më të mëdha e më të bukura sesa makinat këtu në Evropë. Sa ta përfundoj shkollën dhe do të shkoj në Amerikë. E kam ndarë mendjen.

PEER: E si do të shkosh?

PEER JUNIOR: Do të fluturoj.

PEER: Me aeroplan?

PEER: Jo, do të fluturoj vet.

*[Peer e shikon i habitur.]*

PEER: Të fluturosh? Mund ta bësh atë gjë?

PEER JUNIOR: Po.

PEER: Si ashtu?

PEER JUNIOR: Thjesht, e bëj. Trik shqiptar. Nëna thotë se të kam ngjarë ty.

PEER: Hmmm! Ashtu, ë! Ti nuk...

PEER JUNIOR: Çka?

PEER: Ti nuk... nuk merr gjëra të huaja?

PEER JUNIOR: Përse do ta bëja një gjë të tillë! Je në vete ti?

PEER: Nuk e di a jam apo nuk jam në vete. Në të vërtetë, besoj që nuk kam qenë në vete, por tani po, tani jam. Tani jam me dy këmbë në tokë. Po flas metaforikisht. Ama, pavarësisht që kam vetëm një këmbë në tokë, po ndihem shumë më i sigurt, më stabil. Shumë më i sigurt sesa dikur, kur kisha dy këmbë, por fluturoja. Fluturoja nga një ëndërr në ëndërrën tjetër. Por, ëndërra megjithatë ngelet ëndërr. Si i ri kam qenë frikacak. Besoj që kam qenë frikacak, sepse kurrë s'kam pasur guximin ta shoh jetën në sy, ashtu siç është. Gjithmonë i kam bishtnuar, i jam shmangur. Tani jo, tani jetën e shoh në sy dhe më beso, fare s'ia kam frikën.

PEER JUNIOR: Tani po e kuptoj përse nëna gjithmonë më thotë: shqiptarët flasin shumë e nuk thonë asgjë.

PEER: Ashtu thotë, ë?! Epo, thuaj nënës tënde... S'ka rëndësi, mos i thuaj asgjë!

*[Ecin ngadalë dhe pas pak humbin në parkun që ngadalë ka filluar të mbulohet nga mjegulla. Nga larg, si nga një kohë tjetër, dëgjohet zëri i nënës tek i këndon Peer-it.]*

*Vrapo!  
lëvizi këmbët!  
o ngutu, ngutu më shpejtë!  
I ke mbrapa, mu afër teje,  
Vrapo, edhe më shpejtë!  
Ashtu, të lumtë!  
Tash kërcë!  
Edhe një kërcim më të madh,  
Ashtu pra, ashtu bir,  
fluturo bukur!  
Dhe eja në prehrin tim!*

*[Fund]*

“PEER GYNTI NGA KOSOVA”, produksion i Qendrës  
Multimedia nga Prishtina, me regji të Agon Myftarit.  
Premiera 24 maj 2017, Teatri Oda – Prishtinë.  
Fotot: Jetmir Idrizi.









qendra  
multimedia



Botimi i këtij libri u mundësua me përkrahjen bujare të popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID. Përmbytja është përgjegjësi e Qendrës *Multimedia* dhe nuk pasqyron doemos pikëpamjet e USAID apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara. Ky botim është përkrahur përmes Programit Angazhimi për Barazi-E4E, të financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar-USAID dhe realizuar nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim-ATRC.



Qendra Multimedia is supported  
by the European Union Office in Kosovo  
Qendra Multimedia mbështetet  
nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

Katalogimi në botim - (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

821.18-2

Neziraj, Jeton

Peer Gynti nga Kosova / Jeton Neziraj.- Prishtinë.-  
Qendra Multimedia, 2017.- f. 90 ; 21 cm.

ISBN 978-9951-651-22-6